

Shkolla fillore (Volksschule) në Kantonin Aargau



Informacion për prindërit (albanisch)

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**
Abteilung Volksschule

Redaktor

Departement
Bildung, Kultur und Sport
Abteilung Volksschule
Bachstrasse 15
5001 Aarau

Tel. 062 835 21 00

E-Mail: volksschule@ag.ch
www.ag.ch/volksschule

Fotot

Adobe Stock
Kanton Aargau

Copyright

© 2022 Kanton Aargau

Të nderuar prindër

Kjo broshurë përmban informacione mbi sistemin shkollor publik në Kantonin e Aargau-t. Pas një përmbledhje të Shkollës Aargauer, këtu përshkruhet përbërja e saj më e rëndësishme. Përmenden informacione të përgjithshme rreth shkollës shkolla fillore (Volksschule), niveleve të ndryshme të shkollës, si dhe llojeve të ndryshme të shkollave, masat shtesë mbështetëse si dhe informacione dhe oferta të mëtejshme në lidhje me sistemin e shkolla fillore (Volksschule).

Një aspekt i rëndësishëm mbi suksesin e fëmijëve dhe adoleshentëve në shkollë është bashkëpunimi midis shkollës dhe prindërve. Një kapitull i veçantë i kushtohet këtij bashkëpunimi.

Në fund të çdo faqeje keni informacione të mëtejshme sipas temave, me anë të aksesit në faqen e internetit. Ju gjithashtu mund të merrni informacione mbi ngjarjet informative të prindërve. Sapo fëmija juaj kalon nga kopështi (Kindergarten) / në një shkollë, mësuesit dhe administrata e shkollës janë në dispozicionin tuaj për çdo pyetje individuale.

Ne i urojmë fëmijës suaj një shkollim të suksesshëm në Kantonin Aargau!


Departamenti i Arsimit, Kulturës dhe Sportit (Departement Bildung, Kultur und Sport)
Departamenti shkollës fillore (Abteilung Volksschule)

Pasqyrë e shkollave në Aargau

Në Kantonin Aargau shkollimi i detyrueshëm zgjat njëmbëdhjetë vjet.

Tetë vitet e para të shkollës ndahen në **dy vite kopësht (Kindergarten)** dhe **gjashtë vite shkollë fillore (Primarschule)** gjithsej. Kjo vijon me **trevjeçarin e gjimnazit (Oberstufe)** (Niveli sekondar I) (Sekundarstufe I). Gjimnazi është i ndarë në tre lloje të ndryshme të shkollës Shkolla Real (Realschule), Niveli sekondar (Sekundarschule) dhe gjimnaz (Bezirksschule). Ekzistojnë gjithashtu lloje të veçanta të trajnimeve që synojnë fëmijët me nevoja të veçanta.

Pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm, të rinjtë zakonisht hyjnë në **punë** ose shkojnë në shkollën **shkolla e mesme (Mittelschule)** (Sekundarstufe II) (Niveli sekondar II).



Primarschule: EK: Einschulungsklasse

Spezielle Abschlussklassen: WJ: Werkjahr – BWJ: Berufswahljahr – IBK: Integrations- und Berufsfindungsklasse

Berufsbildungsbereich: EBA: Eidgenössischer Berufsattest – EFZ: Eidgenössisches Fähigkeitszeugnis –

BM I: Berufsmaturität

Shkolla fillore (Volksschule) - shkolla e të gjithëve

Të gjithë fëmijët dhe adoleshentët e Kantonit të Aargau-t kanë të drejtë dhe detyrim të ndjekin shkollën për njëmbëdhjetë vjet. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të arsimohen sipas aftësive të tyre. Sipas vendbanimit, ato ndjekin shkollën publike që korrespondon me aftësinë e tyre dhe me kërkesat e së cilës përmbush.

Frekuentimi i shkollës publike është pa pagesë. Pranimi në shkollën e detyrueshme fillon në moshën 4 vjeçare. Për nxënësit ose nxënëset, viti i ri shkollor fillon të hënën e dytë të muajit gusht.

Mësuesit dhe gjithë administrata janë të përkushtuar në promovimin e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve sipas aftësive të tyre. Qëllimi është që të rinjtë të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të vazhduar shkollimin dhe jetën e tyre pas mbarimit të shkollimit të detyrueshëm.

Mundësi financimi dhe edukimi të specializuar

Për fëmijët dhe adoleshentët me nevoja të veçanta shkollore (për shembull talente të veçanta, vështirësi në të nxënë, probleme të sjelljes), mësimet mund të zhvillohen sipas ofertave speciale për mbështetjen e tyre. Ndihma speciale ofrohet për mësimet të rregullta ose koordinohet me to, por gjithashtu mund të zhvillohen dhe klasa speciale.

Fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara ose me probleme të ndryshme mbështeten sipas nevojave (mundësi shtesë arsimore). Financimi kryhet në klasa të rregullta ose në klasa të vogla (Kleinklassen); sipas nevojave të veçanta mësimi zhvillohet në shkolla të specializuara.

Ndërkulturore

Shkolla fillore (Volksschule) jep një kontribut të rëndësishëm në integrimin e fëmijëve dhe të rinjve me prejardhje të ndryshme sociale, gjuhësore dhe kulturore. Më shumë se një e katërta e studentëve flasin një gjuhë tjetër përveç gjermanishtes në shtëpi. Mbështetja specifike në gjermanisht dhe ofertat speciale për të ardhurit krijojnë parakushtet për integrimin e suksesshëm të shkollës dhe eliminimin e prapambetjeve gjuhësore që krijohen.

Kurse për **kulturën dhe gjuhën amtare (heimatliche Sprache und Kultur)** (HSK).shërbejnë për promovimin e gjuhës së parë.

Këto kurse ofrohen nga sponsor të ndryshëm siç janë konsullatat, ambasadat ose shoqatat e prindërve.

Vlerësimi, dëshmitë dhe transferimet

Në kopësht (Kindergarten) niveli i zhvillimit regjistrohet me anë të një fletë vlerësimi. Nisur nga klasa e 1. eshkollës fillore (Primarschule) nxënësit vlerësohen me raportin e pjesshëm në fund të simestrit të parë bashkë me raportin mësimor (shkolla fillore e klasës së parë) ose raportin vjetor me nota (nga shkolla fillore e klasës së dytë) në fund të vitit shkollor. Dosja e vlerësimit me dokumentet përkatëse të performancës shërben si bazë për vlerësimin. Kalimi në klasën tjetër (Promovimi) bazohet në notat që gjenden në çertifikatën vjetore. Transferimi në Real (Real-), Sekondar (Sekundar)- ose Gjimnaz (Bezirksschule) bëhet në bazë të një rekomandimi nga mësuesi i klasës. Kjo bazohet në raportin e përkohshëm të klasës së 6-të ose në dosjen e vlerësimit.

Informacione të mëtejshme ndërkulturore:

www.ag.ch/volksschule > Unterricht & Schulbetrieb > Schule & Interkulturelles

Më shumë informacion mbi vlerësimin / përkthimi dhe broshurat në njëmbëdhjetë gjuhë:

www.ag.ch/leistungsbeurteilung-volksschule

Informacion i përgjithshëm

Pushimet shkollore dhe ditët e pushimit

Datat e pushimeve shkollore dhe ditët e pushimit në shkollë mund të ndryshojnë disi nga komuniteti në komunitet. Datat e pushimeve tregohen në faqen e internetit të shkollës.

Mungesat

Prindërve u kërkohet të informojnë menjëherë mësuesin mbi mungesën e fëmijës së tyre në klasë, dhe të justifikojnë mungesën. Arsyeja e justifikimit mund të jetë sëmundja, aksidentet dhe arsye të tjera të paparashikuara (për shembull vdekje në familje). Mungesat të pajustificuara futen në nivelin e sipërm Gjimnaz (Gjimnaz, Sekondar dhe shkolla Real (Oberstufe (Bezirks-, Sekundar- und Realschule)) në raportin e përkohshëm dhe në raportin vjetor.

Pushimet

Për pushime të planifikuara dhe për të marr leje, prindërit duhet të bëjnë kërkesë me shkrim drejtuar shkollës. Mungesat mund të arsyetohen për këto arsye: Pjesëmarrja aktive në ngjarje të rëndësishme sportive, festa të ndryshme fetare, praktika gjyqësore ose aktivitete të ngjashme.

Shërbimi mjekësor shkollor dhe kujdesi dentar

Mjekët shkollor të Kantonit të Aargau mbështesin shkollat në promovimin dhe parandalimin e problemeve që lidhen me shëndetin. Ekzaminimet mjekësore parandaluese në kopësht dhe në adoleshencë shërbejnë për të parandaluar sëmundjet që lidhen me shëndetin. Zakonisht ato zhvillohen në bashkëpunim me pediatri ose me mjekun e familjes.

Për kontrollin vjetor të dhëmbëve, nxënësit marrin një raport të kontrollit dentar (Broshurëkupon). Për më tepër, mjekët dentar ndjekin rregullisht zhvillimin nga klasa e 1-rë. Kopështi (Kindergarten) deri në klasën e 6-të shkolla fillore (Primarschule). Fëmijët mësojnë si të lajnë në mënyrën e duhur dhëmbët dhe se si të ushqehen shëndetshëm.

Për më shumë informacione në lidhje me edukimin shkollor në Aargau i gjeni të përkthyer në njëmbëdhjetë gjuhë:
www.hallo-aargau.ch

Autoriteti shkollor

Përgjegjës për shkollimin dhe arsimimin në Kantonin Aargau, është Departamenti i Arsimit, Kulturës dhe Sportit (Departement Bildung, Kultur und Sport).

Përgjegjës për drejtimin e shkollor në të gjithë komunitetin është këshilli i komunës (këshilli i komunës) dhe menaxhimi i shkollës.

Mbështetja dhe këshillimi

Nxënësit dhe nxënëset e Shkollës fillore (Volksschule) dhe prindërit e tyre mund të zgjedhin ndërmjet shërbimeve të ndryshme mbështetëse dhe këshillim falas:

Shërbimi psikologjik (Schulpsychologischer Dienst)

Shërbimi psikologjik shkollor nis që nga klasa fillore deri në fund të shkollës fillore. Vështirësitë e të nxënësve dhe të performancës, si dhe vështirësitë psikologjike ose sociale që shfaqen në kopësht apo shkollë, mund të jenë arsye për tu rregjistruar.

Kujdesi shkollor (Schulaufsicht)

Prindërit mund të kontaktojnë me kujdesin shkollor mbi shqetësimet që ato kanë. Ky institucion dëgjon, sqaron dhe ofron mbështetje për të gjitha shqetësimet e prindërve, përmes informacionit në lidhje me orientimin procedural. Duke vepruar në këtë mënyrë, mundësohet një bisedë e drejtpërdrejtë midis prindërve dhe shkollës zhvillohet paraprakisht (shiko. "Schule und Eltern" > "Zuständigkeiten").

Puna sociale në shkollë (Schulsozialarbeit)

Shumë shkolla ofrojnë mundësinë e punës sociale në shkollë. Kjo ka për qëllim studentët e të gjitha niveleve shkollore, të prindërve, mësuesve dhe shkollës në tërësi. Puna sociale në shkollë është bashkëshoqërues i fëmijëve dhe adoleshentëve në procesin e rritjes dhe zhvillimit.

Këshillimi profesional

Shërbimet e këshillimit për trajnimin dhe punësimin (ask!) ofrojnë këshillime mbi të gjitha pyetjet në lidhje me integrimin në profesion, karrierën profesionale dhe arsimimin e mëtejshëm.

Informacion i mëtejshëm mbi temën e shkollës dhe arsimimit në Aargau, përkthyer në njëmbëdhjetë gjuhë:
www.hallo-aargau.ch

Informacion i mëtejshëm mbi mbështetjen dhe këshillimin: www.ag.ch/volksschule > Unterstützung & Beratung

Shkolla dhe prindërit

Një bashkëpunim i mirë midis shkollës dhe shtëpisë është një faktor i rëndësishëm për suksesin e shkollës për fëmijët dhe të rinjtë.

Përgjegjësitë

Nëse prindërit kanë ndonjë pyetje ose informacion mbi shkollën, ato mund të kontaktojnë mësuesin e fëmijës së tyre dhe administratën e shkollës.

Bashkëpunim

Informacione të rregullta nga shkolla

Shkolla është e detyruar të informojë rregullisht prindërit për atë që ndodh në shkollë dhe mbi arritjen e fëmijës. Për këtë qëllim zhvillohen bisedat me prindërit, mbrëmjet e prindërve dhe eventet informuese.

Detyrat dhe të drejtat e prindërve

Prindërit janë përgjegjës për frekuentimin në shkollë të fëmijëve të tyre në mënyrë të rregullt dhe të përpiktë në orare. Prindërit kanë të drejtë të ndjekin klasën e fëmijës së tyre. Ju jeni të detyruar, të pranoni nga këshilli i komunës (këshilli i komunës) ose nga shkolla (drejtues të shkollës, mësues) ftesa të ndryshme mbi eventet prindërore.

Përpara se vendimet e rëndësishme të merren, prindërit kanë të drejtë të dëgohen dhe të kenë akses në dosje. Vendimi përfundimtar për prindërit nga këshilli i komunës (këshilli i komunës) ose nga drejtorja e shkollës me shkrim dhe i arsyetuar. Nëse prindërit nuk janë dakord me këtë vendim, ata kanë mundësinë të paraqesin një ankesë në bordin e shkollës (Bezirksschulrat) sipas zonave ku ndodhen. Shembuj të vendimeve të rëndësishme, që mund të diskutohen dhe të paraqitet ankesë janë:

- Hyrja në klasën e 1. Filllore (Primarschule)
- Caktimi i masave të edukimit, sipas klasave klasa të plota (Einschulungsklasse) apo klasa të vogla (Kleinklasse)
- Transferimi në një Gjimnaz (Oberstufe)
- Promovimi, ndryshimi në shkollë brenda një Gjimnaz (Oberstufe)
- Caktimi në një klasë speciale

Informacion i mëtejshëm mbi shkollën dhe prindërit: www.ag.ch/volksschule> Schule & Eltern

Informacione i mëtejshëm mbi këshillat e shkollave sipas zonave:

www.ag.ch/bks > [Über uns](#) > [Organisation](#) > [Vertretungen & Kommissionen](#) > [Bildung](#) > [Schulräte der Bezirke](#)

Kopështi (Kindergarten)

Kopështi zgjat dy vite. Të gjithë fëmijët që do të mbushin katër vjeç deri në 31 Korrik, do të hyjnë në shkollë fillore, në fillim të vitit shkollor.

Frekuentimi në kopësht shoqëron dhe ndihmon fëmijët në zhvillimin e tyre. Në kopësht fëmijët kanë mundësinë të zhvillojnë interesat e tyre dhe talentet në një ambient të ndryshëm. Mësimi bëhet në mënyrë të këndshme dhe krijon themelet për zhvillimin e aftësive gjuhësore, matematikore, motorrike, sociale dhe emocionale, më tej në shkollë.

Fëmijët që janë të interesuar të lexojnë, shkruajnë dhe matematikore nxiten. Sidoqoftë, nuk zhvillohen mësimet të caktuara në lexim, shkrim apo matematikë. Nëse ata janë veçanërisht të talentuar, një fëmijë mund të kalojë dhe më herët në shkollë fillore (Primarschule).

Gjuha e mësimet në kopësht është përgjithësisht ajo standarte. Fëmijët që nuk flasin gjermanisht në shtëpi, mbështeten në kopësht për të mësuar gjuhën gjermane.

Shkolla fillore (Primarschule)

Shkolla fillore zgjat nga klasa e 1. deri në klasën e 6. Duke nisur nga shkolla fillore, gjuha e mësimit është gjermanishtja.

Në vitet e para shkollore, fitohen kompetencat në lexim, shkrim, matematikë dhe gjuhë e huaj. Temat shkencore, sociale, historike, kulturore dhe ekonomike janë përshtatur në mënyrën e duhur me moshën. Muzika, vizatimi, ushtrimet dhe sporti kanë, gjithashtu një vend të përhershëm në klasë.

Një nga qëllimet e rëndësishme të shkollës fillore është dhe promovimi i pavarësisë, përgjegjësisë personale dhe mësimit shoqëror. Aftësitë e ndryshme mësimore dhe nevojat e nxënësve merren parasysh në klasë. Mësimi në klasë nxit një ndjenjë të të punuarit së bashku, dhe forcon personalitetin e fëmijës.

Gjimnazi (Oberstufe)

Gjimnazet (Niveli-sekondar I) (Sekundarstufe I) ndahet në tre lloje shkolla Real (Realschule), shkolla e mesme (Sekundarschule) dhe gjimnaz (Bezirksschule). Ata ndryshojnë sipas kërkesave të ndryshme të performancës për nxënësit dhe nxënëset. Të tre llojet e shkollave zgjasin tre vite.

Shkolla Real (Realschule)

Shkolla Real është lloji i nivelit bazë me kërkesa themelore të performancës. Në Shkolla Real nxënësit përfitojnë një arsim të përgjithshëm dhe bazat për një shkollim të mëtejshëm. Pas shkollës së mesme, pjesa më e madhe e të rinjve merren me ekonomi, artizanat, industri, shëndetësi dhe punë sociale. Nëse mësimi dhe shkolla profesionale performojnë mirë, ekzistojnë shumë mundësi trajnimi dhe mundësi të mëtejshme për përparim në botën profesionale të të rinjve.

Shkolla e mesme (Sekundarschule)

Shkolla e mesme është lloji i nivelit të lartë, me kërkesa të zgjeruara të performancës. Në shkollën e mesme sigurohet një arsim i gjerë, i përgjithshëm dhe krijohen kushtet e përshtatshme për aftësi profesionale. Disa nxënës dhe nxënëse ndjekin shkollat e mesme shkolla e mesme ekonomike (Fachmittelschule), shkolla e mesme e shkencave (Wirtschaftsmittelschule) ose shkolla e mesme informatike (Informatikmittelschule).

Gjimnazi (Bezirksschule)

Gjimnazi është lloji i nivelit të lartë, më kërkesa të larta. Përgatitjet janë si për një shkollim sipas nevojave që kërkohen shkollë e mesme (Mittelschule) (gjimnaz (Gymnasium) / shkollë e mesme ekonomike (Fachmittelschule) / shkollë e mesme e shkencave (Wirtschaftsmittelschule) / shkollë e mesme informatike (Informatikmittelschule). Pjesa më e madhe e të rinjve zgjedhin të fillojnë një arsim profesional në fushën e artizanatit, industrisë, shërbimeve të ndryshme, një pjesë tjetër zgjedhin shkollën e mesme.

Klasat speciale

Për vitin e fundit shkollor, ka klasa të veçanta përfundimtare që ndodhen vetëm në disa vende apo vetëm në disa komunitete. Në këto klasa, të rinjtë marrin mbështetje shtesë për tu integruar më tej në botën profesionale. Klasat janë si më poshtë:

- Përzgjedhja karrierës (Berufswahljahr)
- Viti i punësimit (Werkjahr)
- Integrim dhe përcaktim i karrierës (Integrations- und Berufsfindungsklasse)

Informacione i mëtejshëm mbi gjimnazin: www.ag.ch/schulstufen > Oberstufe
Informacione i mëtejshëm për planin mësimor: www.ag.ch/lehrplan

Pas shkollës fillore (Volksschule)

Pas përfundimit të shkollës së detyrueshme, pjesa më e madhe e të rinjve zgjedhin të vazhdojnë një shkollë profesionale ose vazhdojnë të frekuentojnë shkollën.

Formimi profesional

Formimi profesional (berufliche Grundbildung) është baza e formimit fillestar më e rëndësishmja në Zvicër. Ajo u jep mundësinë të rinjve të hyjnë në tregun e punës, si dhe ju jep atyre baza të forta profesionale. Përveç formimit praktik në një ndërmarrje, të rinjtë profesionistë ndjekin një shkollë profesionale (Berufsfachschule) një ose dy ditë në javë. Sipas formimit, kjo shkollë zgjat nga dy në katër vite: Një formim profesional që zgjat nga tre në katër vite, përfiton një certifikatë profesionale aftësie EFZ (eidgenössischen Fähigkeitszeugnis EFZ), një formim profesional prej dy vitesh, përfiton një certifikatë profesionale federale EBA (eidgenössischen Berufsattest EBA).

Një shkollim i përfunduar është një parakusht i rëndësishëm për të provuar veten më vonë në tregun e punës. Ajo hap shumë perspektiva karrierës dhe në të ardhmen ofron më shumë mundësi trajnimi të mëtejshme.

Përveç mësimëve të detyrueshme në shkollën profesionale, të rinjtë e talentuar dhe të motivuar që kryejnë një formim profesional, mund të ndjekin shumë mësimë plotësuese dhe të përfundojnë trajnimin e tyre në një **kolegj profesional (Berufsmaturität)**. Kjo ofron mundësinë e studimit në një Universitet të shkencave të aplikuara (Fachhochschule).

Shkolla e mesme (Mittelschulen)

Shkollat e mesme ndjekin njëmbëdhjetë vitet e detyrueshme të shkollës fillore. Në varësi të llojit të shkollës, ato japin certifikata të ndryshme dhe mundësojnë pranimin në shkolla të larta teknike (höhere Fachschulen), kolegje shkencore (Fachhochschulen) ose universitete (Universitäten).

Në Kantonin Aargau mund të vizitoni shkollat e mesme të mëposhtëme:

- Gjinnazet (Gymnasium)
- Shkollat shkencore (Fachmittelschule)
- Shkolla ekonomike (Wirtschaftsmittelschule)
- Shkolla informatike (Informatikmittelschule)

Informacione të mëtejshme mbi formimet profesionale: www.ag.ch/berufsbildung > Lehre

Informacione të mëtejshme mbi shkollat e mesme dhe mbi kushtet e regjistrimit: www.ag.ch/mittelschulen

**Departement
Bildung, Kultur und Sport**

Abteilung Volksschule
Bachstrasse 15
5001 Aarau